



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:163782

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505745

C.nr.610/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri me Bashkëpunëtorin Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësit A. K. nga fshati Ll. Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Daut Krasniqi nga Malisheva, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë me rastin e daljes në pension, vlera e kontestit **2,103.21 euro**, jashtë seancës gjyqësore me datën **26.03.2024** mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K. nga fshati Ll.-Komuna e Malishevës, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit **A. K.** t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej **2,103.21 euro** (dymijë e njëqind e tri euro e njëzetë e një cent) dhe atë shumat si në vijim:

- a) Në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite përvojë pune, t'ia paguaj shumën prej **631.50 euro** (gjashtëqind e tridhjetë e një euro e pesëdhjetë cent), apo 150% të pagës bazë dhe
- b) Në emër të kompensimit të 3 pagave përcjellëse, t'ia paguaj shumën prej **1,471.71 euro** (njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e një cent) dhe të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% që nga data e paraqitjes së padisë me datë 23.07.2021 dhe në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në nën pikën a) të pikës I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar, dhe atë në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 104.35 euro.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve:

Paditësi A. K. nga fshati Ll.-Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit të tij av. Daut Krasniqi nga Malisheva, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim të 3 pagave përcjellëse me rastin e daljes në pension dhe 3 pagave jubilarë. Sipas padisë, paditësi ka punuar si profesor në SHFMU “Xh. K.-Ll.” në D./Malishevë më tepër se 40 vite e deri në daljen në pension me datë 03.06.2021. Ka theksuar se paditësi i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Komunën e Malishevës, por në kërkesë nuk i është kthyer përgjigje pozitive, kështu që i është drejtuar gjykatës dhe i ka propozuar që të aprovohet padia e paditësit si e bazuar.

I autorizuari i paditësit përmes parashtresës së datës 22.02.2024, ka bërë plotësimin dhe precizimin e padisë duke theksuar se kërkesëpadia për tri (3) paga përcjellëse me rastin e daljes në pension rezulton të jetë 1,471.71 euro duke e llogaritur me një pagë mujore neto 490.57 euro dhe për pagën jubilarë e ka precizuar duke e kërkuar një pagë e gjysmë (1.5) jubilarë në shumën prej 735,85 euro, apo gjithsej 2207.56 euro, me kamatë vjetore prej 8% prej datës së paraqitjes së padisë në gjykatë 23.07.2021 e deri në realizimin definitiv.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi e cila është pranuar me datë 12.08.2021, mirëpo e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje në padi, ndërsa me datën 22.02.2024 e ka njoftuar edhe me precizim të kërkesëpadiës, ku kësaj radhe ka kthyer përgjigje.

Në përgjigje, e paditura e ka kontestuar padinë e paditësit si të pabazuar për arsye se nuk ka mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit e cila është lidhur në mes të SBASHK-ut dhe MASHT-it dhe kjo Kontratë është shkëputur me datë 22.11.2022 nga MASHT.

Ka shtuar se pagën jubilarë e kanë realizuar të gjithë mësime dhënësit në kohën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive, dhe se paditësi nuk ka bazë juridike për pagën jubilarë, sepse nuk dihet se për cilin jubilar e ka kërkuar pagën.

Në fund i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar për nga baza ligjore sa i përket pagës jubilarë.

Vlerësimi i gjykatës:

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: Kërkesën e paditësit të parashtruar tek e paditura për pagesën e pagave përcjellëse të datës 05.07.2021 nr....., vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit nr.... të datës 24.05.2021 të lëshuar nga drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, listën e pagave nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe kopjen e letërnjoftimit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në precizim të padisë të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga kërkesa e paditësit për pagesën e pagave përcjellëse dhe pagave jubilar nr.... datës 05.07.2021 e parashtruar tek e paditura, vërtetohet fakti se paditësi ka kërkuar ti bëhet kompensimi i pagave, por nuk ka marrë përgjigje nga e paditura.

Gjykata, përmes vendimit me numër 11/1319 të datës 24.05.2021, të lëshuar nga drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, ka vërtetuar faktin se paditësi A.K. ka qenë në marrëdhënie pune pranë SHFMU "X. K.-L1." në D., në pozitën profesor i lëndës së historisë dhe gjeografisë dhe me datën 02.06.2021 ka arritur moshën e pensionimit (65 vjet).

Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësi pagën bazë e ka pasur në lartësi prej 421.00 euro, pagën neto 490.57 euro, kurse përvojë pune i ka pasur 43 vite dhe kjo listë e pagave vërtetohet edhe me numrin personal nga kopja e letërnjoftimit të paditësit.

Kontestuese ka qenë nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të mjeteve në emër të tri (3) pagave përcjellëse me rastin e daljes në pension dhe shpërblimi jubilar për 40 vjet të përvojës së punës.

Baza ligjore:

Vendimin e lartcekur, gjykata e ka pranuar si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se: *"Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të"*, andaj meqë vendimi me numër ... i datës 24.05.2021, është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që provës së lartcekur, gjykata ia fali besimin si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me kohën e pensionimit për këtu paditësin A.K..

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me numër të njësisë 01B, numër të prot.105, të datës 22.01.2021, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është paraparë se: *"Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: nën par.8.4: "Për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë"*, pra

në rastin konkret paga bazë e paditësit ka qenë 421.00 euro dhe kur e kalkulojmë me 150% të kësaj page, atëherë shuma del të jetë 631.50 euro.

Në anën tjetër sa i përket tri pagave përcjellëse në lartësi të tri pagave me rastin e daljes në pension, gjykata u bazua po ashtu në nenin 35 paragrafi 9 ku përcaktohet se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension, përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”*, pra në rastin konkret, në emër të tri pagave përcjellëse, paditësit i kanë takuar gjithsejtë 1,471.71 euro duke i llogaritur 3 paga neto në lartësi prej 490.57 euro (3 x 490.57 = 1,471.71 euro).

Pra, me nenin 35 paragrafin 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) me numër të njësisë 01B, numër të protokollit 105, të datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve (anëtarë të SBASHK-ut) që në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit, ndërsa me paragrafin 9 të të njëjtit nen të kontratës së lartcekur është përcaktuar përfitimi i tri pagave përcjellëse me rastin e daljes në pension, kurse paragraf 9.1 i nenit 35 përcakton se pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit.

Gjykata, vendosi si në pikën -I- nën pikën a) dhe b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, pasi që vlerësoi se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit Arif Krasniqi si punëtor i arsimit-mësimdhënës, në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite përvojë pune, t’ia paguaj kompensimin në vlerë të 150 % të një pagë bazë (vlera e pagës bazë 421.00 €). Kjo pasi që paditësi bazuar në listën e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës i ka arritur 43 vite të përvojës së punës, kurse bazuar në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit, me numër 11/1319 të datës 24.05.2021, paditësi ka arritur moshën e pensionimit me datë 02.06.2021, prandaj ia ka njohur edhe tri paga përcjellëse në shumën e përgjithshme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozita e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) me numër të njësisë 01B, numër të protokollit 105, të datës 22.01.2021, neni 35 par.8 dhe par. 9.

Gjykata vendosi si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitën ligjore 399 paragrafi 1 të LPK-së, e cila përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ku pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së aprovuar si në nën pikën a) të pikës -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar në emër të shpërblimit jubilar, në lartësi prej 104.35 euro, është e pazuar.

Gjykata ka vlerësuar se duhet bërë shpërblimi për pagën jubilarë duke marrë për bazë pagën bazë e cila është në lartësi prej 421.00 euro dhe kjo duke u bazuar në listën e pagave nga buxheti i Republikës së Kosovës gjatë kohës kur paditësi ka qenë mësimdhënës, dhe jo siç ka

kërkuar paditësi që atij ti llogaritet me pagën neto 490.57 euro. Paga bazë 421.00 kur kalkulohet me 150% për 40 vjet përvojë pune, atëherë shuma del të jetë 631.50 euro, kurse meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, lidhur me kërkesën për kompensimin e 3 pagave përcjellëse, u vendos që të njëjtat ti aprovoj tërësisht pra në shumën 1471.71 euro ($490.57 \times 3 = 1,471.71$ euro).

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje të precizimit në padi, lidhur me pjesën aprovuese sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot. Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit dhe duke e llogaritur kamatën ligjore prej 8 %, bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së nga dita e parashtrimit të padisë (23.07.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mori konform nenit 449 dhe 453 si dhe Rregullores për Tarifat Avokatëve të Kosovës, duke e detyruar të paditurën që t'ia paguaj shumë e përgjithshme prej 124.00 euro, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00.

Andaj, bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.610/21, datë 26.03.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.